



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. Nr. 01/1689

Datë: 06.08.2021

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan shpall:

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor për vitin akademik 2021/2022

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 98 dhe 101 të Statutit, në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2021, ka miratuar propozimet e njësive akademike për numrin e studentëve që do të pranojnë në vitin akademik 2021/22. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejshëm MASHTI) sipas Referencës 01B/69 dhe Nr.prot. 1337, dt.05.08.2021.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2021/2022, do të regjistrojë **725** studentë të rregullt në studime baçelor.
2. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri **88** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja **2%**. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës I është deri **16** studentë baçelor. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë kryer në ato vende .
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen edhe **2%** e kandidatëve nga Shqipëria dhe Maqedonia, përkatësisht **16** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
5. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen **1%** të kandidatëve nga Mali i Zi, përkatësisht **8** studentë të rregullt baçelor, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
6. Universiteti do t'i ketë në konsideratë në mënyrë të veçantë edhe kandidatët me nevoja të veçanta të cilët e kalojnë pragun e provimit pranues.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin “Kadri Zeka” kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHTI-t, e cila u dorëzohet të gjitha njësisive akademike.
9. Kandidatët të cilët kanë diploma jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
10. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
11. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
12. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.

13. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në kuadër të Universitetit “Kadri Zeka” nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
14. Kandidatët për pranim si student në Universitetin “Kadri Zeka” në vitin akademik 2021/22 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:

- a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
- b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
- Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
1. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku **40%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
 2. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku **40%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
 3. Kandidatët nga Lugina e Preshevës, Shqipëria, Maqedoni, Mali i Zi dhe komunitetet, mund të rangohen në listën e të pranuarve nëse kanë arritur së paku **30%** të pikëve nga provimi pranues.
 4. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve

do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh sukcesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe sukcesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.

5. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë, bëhet në administratën e njësisë akademike, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

Provimi pranues, për shkak të pandemisë COVID-19 do të mbahet në një periudhë më të gjatë, respektivisht më datë 31.08.2021 dhe 01.09.2021; , sipas orarit si në vijim:

Grupi I. Fakulteti i Edukimit – baçelor më datë **31.08.2021** në ora **9:00**

Grupi II. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - baçelor më datë **31.08.2021** në ora **12:00**

Grupi III. Fakulteti i Shkencave Aplikative - baçelor më datë **31.08.2021** në ora **13.00**

Grupi IV. Fakulteti Ekonomik – baçelor më datë **01.09.2021** fillon në ora **9:00**

Grupi V. Fakulteti Juridik – baçelor më datë **01.09.2021** fillon në ora **12.00**

- Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të jenë të pajisur me maskë mbrojtëse (Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës) dhe me vete të posedojnë konfirmimin e aplikimit dhe letërnjoftimin, pa të cilat nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
- **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online smu.uni-gjilan.net hapet prej datës **06.08.2021** deri më datë **24.08.2021** në ora 16.00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë 06.08.2021, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **9:00**.
3. **Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online** do të bëhet prej datës **25.08.2021** deri më datë **28.08.2021**. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personel i administratës së fakultetit përkatës.

4. Më **30.08.2021** do të publikohet në ueb-faqen e universitetit lista e kandidatëve dhe sallave ku do të mbahet provimi pranues.
5. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç 'regjistrim nga fakulteti.
6. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:**
 - a) *Ekstrakti i lindjes (origjinal) jo më i vjetër se 6 muaj,*
 - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose dublikatë),*
 - c) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (origjinal, të noterizuar ose dublikatë),*
 - d) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose dublikatë),*
 - e) *Kopjen e letërnjoftimit,*
 - f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: smu.uni-gjilan.net***
 - g) *Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: smu.uni-gjilan.net**, ndërsa pagesa bëhet në cilëndo bankë,*
 - h) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit-Lista e institucioneve parauniversitare të licencuara në vend, sigurohet në MASHTI (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*
7. **Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit III, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli, t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.**
8. **Të gjithë kandidatët janë të obliguar që të respektojnë rekomandimin e IKSHP për ruajtjen e distancës prej 1,5-2 metra dhe të përdorin maskën mbrojtëse.**
9. Dokumentet nën pikën b) c) dhe d) mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmohen me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. **P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati, pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.**

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. Shpallja e rezultateve preliminare e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e universitetit sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë: **më së voni deri më datë 02.09.2021, në ora 16:00;**
2. *Me rastin e shpalljes së rezultatit preleminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, sepse pas ankesës dikush nga kandidatët mund të radhitet me lartë me pikë se kandidati i cili ishte radhitur sipas rezultatit preleminar.*

V. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preleminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare** (llogaritet edhe dita e shtunë), respektivisht për grupet si në vijim: **Ankesat bëhen më së voni deri më datë 04.09.2021, në ora 16:00;**
2. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshënuar ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet, menjëherë pas mbylljes së afati ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës.
3. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **08.09.2021 -10.09.2021 (3 ditë pune).**
4. Pranimi i kandidatëve si paragrafin 3 të kësaj pike do të bëhet vetëm pas shprehjes së interesimit për pranim në programin përkatës.
5. **Në departamentet, degët, drejtimet ose programet, ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.**
6. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-gjilan.net

11/11/2021

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e universitetit, pas shqyrtimit të ankesave sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë: **më së voni deri më datë 06.09.2021, pas orës 16:00;**

VII. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Njësitë Akademike të Universitetit “Kadri Zeka”.
Data dhe koha e regjistrimit do të shpallet në web - faqen zyrtare www.uni-gjilan.net
2. Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **15.09.2021, në ora 15:00**. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj lutem që t’i përmbahen afatit të lartshënuar.
3. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar, nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
4. Kandidatët e pranuar nga Lista Përfundimtare, për regjistrim/fotografim duhet të paraqesin letërnjoftimin.
 - Kandidatët që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës duhet të kenë edhe fletëpagesën e semestrit.
 - Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin e Gjilanit vitin e parë të studimeve e kanë falas.
5. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj lutem që t’i përmbaheni afatit të lartshënuar.

STUDIMET BAÇELOR

Tabela me numrat e paraparë për studentë të rinj për vitin akademik 2021-2022 sipas njësive akademike dhe programeve

Fakulteti	Programi	Nga Kosova	Lugina e Preshevës 2%	Komunitetet jo-shumicë 12%	Shqipëria & Maqedonia 2%	Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukim	Fillor	41	1	6	1	1	50
	Parashkollor	33	1	5	1	0	40
Ekonomik	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar	148	4	22	4	2	180
	Menaxhment dhe Ndërmarrësi	83	2	12	2	1	100
Juridik		148	4	22	4	2	180
Shkenca Kompjuterike		124	3	18	3	2	150
Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	20	1	3	1	0	25
TOTAL		597	16	88	16	8	725

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

- **Programi Fillor:** Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare
- **Programi Parashkollor:** Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare

II. FAKULTETI EKONOMIK

- **Të gjitha drejtimet:** Hyrje në ekonomi dhe Matematikë

III.FAKULTETI JURIDIK

- **Juridik i Përgjithshëm:** Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Edukatë qytetare.

IV.FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

- **Shkenca Kompjuterike:** Informatikë dhe Matematikë.

V. FAKULTETI I SHKENCAVE APLIKATIVE

- **Matematikë Aplikative:** Matematikë.